



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI I MINISTRAVE
Agjencia e Prokurimit Publik

Adresa : Bulevardi "Deshmoret e Kombit", Keshilli i Ministrave Tel.& Fax. 04 2277510

Nr. 89333 Prot.

Tiranë, më 03.09.2013

U D H Ë Z I M

Nr.06 datë 03.09.2013

PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
SHËRBIMET E PËRKUJDESJES SHOQËRORE

Agjencia e Prokurimit Publik, për t'i ardhur në ndihmë të gjitha autoriteteve kontraktore, të cilat, prokurojnë shërbimet e përkujdesjes shoqërore, nëmbështetje të nenit 13 pika 2/d të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar, si dhe Kreut XI, shkronja "a" të Vendimit Nr.1, datë 10.01.2007 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", të ndryshuar,

Udhëzon:

1. Nëse një autoritet kontraktor do të ketë nevojë për shërbim të përkujdesjes shoqërore, rezidenciale ose ditore, atëherë në mbështetje të nenit 28/1 të LPP-së dhe pikës 2/c të Kreut II të VKM nr.1, date 10.01.2007 "Për miratimin e rregullave te prokurimit publik", do të bëhet përllogaritja e fondit limit për objektin e prokurimit. Kjo përllogaritje mund te bëhet nga njësia e prokurimit ose në rast se kjo njësi nuk ka kapacitetet e duhura, mund të bëhet nga struktura të tjera të specializuara brenda autoritetit kontraktor, të cilat ngrihen për këtë qëllim nga titullari i autoritetit.

Eksperienca të mëparshme të ngjashme, të realizuara me financime të donatorëve, mund të përdoren për sa është e mundur në përllogaritjen e fondit limit.

2. Nëvarësi tëvlerës limit tëkontratës për objektin që do të prokurohet, njësia e prokurimit mund të përzgjedhë një nga procedurat, që parashikon neni 29 i LPP-së.

Në rast se, autoriteti kontraktor nuk ka një projekt për shërbimin që kërkon të prokurojë, mund të përzgjedhë si procedurë prokurimi “shërbimin e konsulencës” e cila, ofron shërbim të një natyre intelektuale dhe këshilluese. Në lidhje me zhvillimin e kësaj procedure prokurimi, autoriteti kontraktor mund të referohet në pikën 3 tëKreut VI, të VKM-së nr.1, date 10.1.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe të përdorë setin përkatës tëDokumenteveStandarde te Tenderit të miratuara nga APP-ja.

3. Pas përllogaritjes sëvlerës limit tëkontratës dhe përzgjedhjes së procedurës së prokurimit, njësia e prokurimit pranë autoritetit kontraktor procedon me hartimin e urdhrave përkatëse si: urdhrine prokurimit, urdhrin për ngritjen e komisionit të vlerësimit të ofertave (*perberja e anetarëve të KVO-së përcaktohet nga titullari i autoritetit kontraktor duke patur parasysh kërkesat e përcaktuara në pikën 2/ç, të Kreut V, të VKM-së nr.1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave te prokurimit publik”, te ndryshuar*) si dhe me hartimin e miratimin e dokumenteve të tenderit.

4. Në hartimin e kriterëve për përzgjedhjen e ofertuesve duhet të mbahen parasysh kërkesat ligjore të përcaktuara në nenet 45 dhe 46 të LPP-së, njëkohësisht, autoritetet kontraktore mund të vendosin kriterë të tjera në përputhje me ligjin e prokurimit publik dhe aktet nënligjore të tij, përsa kohë, që këto kriterë, nuk do të jenë diskriminuese apo të pengojnë konkurrencën në treg të operatorëve ekonomikë.

Njësia e prokurimit duhet tëbëjë kujdes që në hartimin e kriterëve specifike për kualifikim, të kërkojëlicencat përkatëse për këtë lloj

shërbimi, me qëllim qëoperatorët ekonomikë(përfshirë edhe Organizatat Jofitimprurëse, më tej OJF), që kanë si objekt të veprimtarisë së tyre shërbimin e përkujdesjes shoqërore të plotësojnë të gjitha kushtet për ofrimin e këtij lloj shërbimi në cilësinë e kërkuar.

Njëkohësisht, mund të kërkohen standardet përkatëse të parashikuara për këtë lloj shërbimi apo të kërkohen certifikata të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë.

5. Në lidhje me vlerësimin e ofertave të paraqitura duhet të përdoren kriteret e vlerësimit të përcaktuara nëdokumentet e tenderit. Nëse do të gjykohet se, vlerësimi vetëm mbi bazën e kriterit “çmimi më i ulët” do të ishte i papërshtatshëm, atëherë, mund tëpërzgjidhet nëdokumentet e tenderit kriteri i vlerësimitte“ofertës ekonomikisht më të favorshme”,sipas parashikimeve të përcaktuara në pikën 1/b të nenit 55 të LPP-së. Në rast se, autoriteti kontraktor do të zgjedhë të përdorë këtë lloj kriteri vlerësimi duhet te ketë parasysh qe të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast, kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të çmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100, sipas formulës së përcaktuar nëDokumentetStandarde të Tenderit.

Në rast se, autoriteti kontraktor ka përzgjedhur të përdorë procedurën e prokurimit “Shërbim konsulence”, atëherë, duhet të ndiqen rregullat që parashikon Kreu VI i VKM nr.1 date 10.1.2007 në lidhje me vlerësimin e ofertave për këtë lloj procedure prokurimi si dhe në setin përkatës të dokumentevstandarde të tenderit.

6. Hapja dhe vlerësimi i ofertave do të bëhet nga komisioni i vlerësimit të ofertave i ngritur me urdhër tëposaçëm nga titullari i autoritetit kontraktor, duke respektuar parashikimet e përcaktuara në Kreun V, pika 4 të VKM-së nr.1, date 10.1.2007.

D R E J T O R

Klodiana CANKJA